



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

---

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2010, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve si dhe duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.2008/09 për transparencë në komuna, mori këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1.**

Me këtë vendim ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 2.**

Diskutimi publik zgjatë nga data 30.04 deri më 15.05.2010.

**Neni 3.**

Obligohet zyra Komunale për Informim që Draftin e Rregullores të e vejë në tabelën e shpalljeve të komunës dhe vende tjera të frekuentuara në qytet, ne Web-faqen e Komunës, ndërsa përmes radio stacionit lokal “Vicianum” të informohen qytetarët për vënien në diskutimin publik të kësaj Rregulloreje duke dhënë informacion për mënyrën e qasjes në të njëjtën si dhe të informoj se kopja mund të merret në Zyrën e informimit. Gjithashtu, nga një kopje e Draft-Rregulloreje të ju dërgohet Këshillave të fshatrave në territorin e Komunës së Vushtrrisë, ndërsa hartuesi i Draft- rregullores të organizoi tubim publik me qytetarë për diskutim dhe dhënie të propozimeve eventuale lidhur me draftin e rregullores në fjalë.

**Neni 4.**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit në mbledhje të Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Ferit Idrizi**



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI

Në bazë të nenit 17 pika "f" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4, të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 31 të Rregullores për Shërbimet Komunale dhe Rregullimin e qytetit 01 Nr.731/04 të dt. 29.09.2004, si dhe kërkesës së Kompanisë Ujësjetësi Regjional, Sh.A. "Mitrovica" në Mitrovicë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2010, merr këtë:

#### VENDIM

#### PËR RACIONALIZIMIN E PËRDORIMIT TË UJIT TË PIJSHËM GJATË PERIUdhËS EMERGJENTE PËR SHKAK TË MUNGESËS SË UJIT NË SISTEM

##### Neni 1

Me këtë Vendim përcaktohen masat dhe kriteret e përdorimit racional të ujit të pijes gjatë periudhës emergjente, për shkak të mungesës së ujit në sistemin publik të ujësjetësit në Komunën e Vushtrrisë.

##### Neni 2

#### **Definicione:**

"Periudha e emergjencës" nënkupton periudhën prej 01 Maj 2010 deri më 31 tetor 2010.

"Uji i pijshëm" nënkupton ujin nga sistemi publik i furnizimit me ujë të pijshëm,

"Person" nënkupton personin fizik ose juridik,

"Person i kualifikuar" nënkupton atë që e ka të regjistruar biznesin për Autolarje.

##### Neni 3

#### **Gjatë periudhës së verës (emergjencës) për shkak të mungesës së ujit të pijshëm:**

3.1 Ndalohet larja e paautorizuar e rrugëve, trotuareve dhe vendeve tjera publike.

3.2 Ndalohet ujitja e kopshteve dhe oborreve.

3.3 Ndalohet puna e autolarjeve të cilat shfrytëzojnë ujin nga rrjeti i ujësjellësit.

3.4 Ndalohet larja e hapësirave të përbashkëta të çfarëdo ndërtese, në sektorin individual dhe kolektiv të banimit, dhe atë afariste duke përfshi shkallët, oborret, trotuaret e të ngjashme.

3.5 Ndalohet çfarëdo shfrytëzimi jo i domosdoshëm i ujit.

#### Neni 4

##### **Ndalimi i humbjes së ujit të shkaktuar nga rrjedhjet**

4.1 Në qoftë se ka humbje (rrjedhje) të ujit të pijshëm në rrjetin dhe instalimet e ujësjellësit, në lokale apo rreth lokaleve, ndërtesa banimi, oborre, shtëpi, etj, Inspekcioni komunal në Vushtrri dhe Kompania Ujësjellësi Regjional, Sh.A. "Mitrovica" në Mitrovicë janë të obliguar të ndërmarrin të gjitha masat ligjore kundër pronarëve dhe t'i detyrojnë që rrjedha e ujit të ndërpritet. Nëse pronari nuk e eviton prishjen, Inspekcioni komunal ndërmerr masat ligjore në dispozicion dhe i urdhëron Kompanisë Ujësjellësi Regjional "Mitrovica" në Mitrovicë, që me shpenzimet e pronarit ta ndërprejn rrjedhjen e ujit.

4.2 Inspektorët dhe punëtorët e Kompanisë Ujësjellësi Regjional "Mitrovica" kanë të drejt të hyjnë në lokale, oborre dhe shtëpi për ta verifikua humbjen e ujit dhe janë të detyruar të ndërmarrin masa për pengimin e humbjes së ujit.

4.3 Obligohet KRU Sh.A. "Mitrovica" në Mitrovicë që ta ndërpres çdo rrjedhje të ujit në rrjetin primar dhe sekondar të ujësjellësit. Mbikëqyrjen inspektuese e bënë Drejtoria e Inspektoratit të Komunës dhe ndërmerr masa ligjore kundër sjelljeve pa përgjegjësi të Kompanisë Ujësjellësi Regjional Sh.A. "Mitrovica".

4.4 Obligohet kompania që faturimin e harxhimit të ujit ta bëjë në bazë të nenit 26 të Rregullores komunale mbi shërbimet komunale dhe rregullimin e qytetit. Faturimi bëhet vetëm në bazë të gjendjes së ujëmatësit, e jo në mënyrë të paragjykuar (paushall) si po veprohet deri më tani. Kjo metodë do t'i zbuloi harxhuesit e mëdhenj të ujit dhe do t'i detyroj ta reduktojnë harxhimin e ujit.

#### Neni 5

##### **Gjobat dhe masat tjera**

Mos zbatimi i këtij vendimi paraqet kundravajtje. Për kundravajtje sipas kësaj rregulloreje do të shqiptohen gjobat si në vijim:

5.1 Larja e paautorizuar e rrugëve, trotuareve, parkingjeve dhe vendeve tjera publike: prej 150 deri 200 €uro.

5.2 Ujitja e kopshteve dhe oborreve: prej 200 deri 300 €uro.

5.3 Autolarjet të cilat e shfrytëzojnë ujin nga rrjeti i ujësjellësit në kundërshtim me këtë Urdhëresë: prej 300 deri 350 €uro.

5.4 Larja e hapësirave të përbashkëta të çfarëdo ndërtese, në sektorin individual dhe kolektiv të banimit, dhe atë afariste, duke përfshi shkallët, korridoret, tarracat e të ngjashme: prej 50 deri 70 €uro.

5.5 Shfrytëzimi jo i domosdoshëm i ujit: 300 €uro.

5.6 Për kyçjen ilegale në rrjetin e ujësjellësit: 500 €uro.

5.7 Në raste të përdorimit të ujit të pijshëm nga ujësjellësi për ujitjen e kulturave bujqësore do të aplikohen edhe dispozitat ligjore në fuqi për keqpërdorim dhe vjedhje të ujit.

#### Neni 6

6.1 Kompetent për zbatimin e këtij Vendim janë: Drejtoria Komunale e Inspektoratit në Vushtrri, Kompania Ujësjellësi Regjional Sh.A. "Mitrovica" në Mitrovicë, Policia e Kosovës – Njësia në Vushtrri dhe Gjykata Komunale për Kundravajtje në Vushtrri.

#### Neni 7

#### **Hyrja në fuqi**

7.1 Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe do të zbatohet gjatë tërë periudhës së emergjencës.

Kryesuesi i Kuvendit

**Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**



**KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI**

Në bazë të nenit 40.2 “c” dhe 40.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4, dhe nenit 30.3 dhe 54.2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2010, merr këtë:

### **VENDIM**

#### **Neni 1**

Nga Buxheti i Komunës - fondi për transfere dhe subvencione lejohen mjete financiare në shumë të përgjithshme prej 16.300.00 €, për ndihmë klubeve sportive të Komunës së Vushtrrinë.

#### **Neni 2**

Autorizohet Kryetari i Komunës që në bashkëpunim me Drejtorin e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport të vendosin për shumat e mjeteve financiare që do të i ndahen secilit klub sportiv, të propozuar në këtë mbledhje të kuvendit të komunës.

#### **Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport në Vushtrri.

#### **Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit

**Kryesuesi i kuvendit  
Ferit Idrizi**



## REPUBLIKA E KOSOVËS

## KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI

Në bazë të nenit 17 “f” dhe 40.2 “c” dhe 40.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4, dhe nenit 30.2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2010, merr këtë:

### VENDIM

#### Neni 1

1.1 Nga Buxheti i Komunës - fondi për bashkëfinancim lejohen mjete financiare në shumë të përgjithshme prej 188.737.00 €, për ndërtim - shtruarje me kubëza betoni të 11 (njëmbëdhjetë) rrugëve dhe ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në dy rrugë në qytet, për të cilat komuna do të siguroj 161.751.96 €, ndërsa komuniteti 31.770.00 €.

1.2 Rrugët që do të ndërtohen:

• Rruga “Jeton Terstena” L=250m, b=4m, t=8cm. vlera .....	16 087,50 €.
• Rruga “Mehmet Pashë Zogaj” L=336m, b=4m, t=8cm. vlera...	22149.60 €.
• Rruga “Hamdi Hajrizi”, L=266m, b=4m, t=8cm. vlera .....	16288.10 €.
• Rruga “Hamdi Krasniqi” L=260m, b=4.50m, t=8cm. vlera .....	18856.90 €.
• Rruga “Shaban Polluzha” L=300m, b=5m, t=8cm. vlera.....	237.34 €.
• Rruga “Gjon Buzuku” L=190m, b=4.5m, t=8cm, vlera .....	13711.14 €.
• Rruga “Marin Barleti” L=299m, b=3m, t=8cm, vlera .....	14953.99 €.
• Rruga “Naim Zahiti” L=110m, b=5m, t=8cm. vlera .....	8735.80 €.
• Rruga “Vëllezërit Frashëri” L=100m, b=4m, t=8cm, vlera.....	6635.00 €.
• Rruga “Rushit Strovci” L=350m, b=4m, t=8cm, vlera .....	22012.50 €.
• Rruga “Sahit Avdulli” L=437m, b=3.5m, t=8cm.vlera .....	25572.85 €.
<b>Gjithsejtë: .....</b>	<b>188.737.38 €.</b>

1.3 Ndërtimi i ujësjellësit:

• Rruga “Sahit Avdulli” L=437 m, Ø63 mm, vlera .....	3.376.78 €
• Rrugs “Hajzer Jashari”, L=150 m, Ø63 mm, vlera .....	1.407.80 €
<b>Gjithsejtë: .....</b>	<b>4.784.58 €</b>

**Totali:.....193.521.96 €**

## Neni 2

2.1 Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim Publik që në suaza të kompetencave të tyre ligjore të i ndërmarrin veprimet e nevojshme procedurale për realizim me kohë dhe në cilësi të projekteve rrugore të cekura si në nenin paraprak.

## Neni 3

3.1 Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit  
Ferit Idrizi



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

*Rr. "Adem Jashari" nr.1, Tel.028/571-524, Fax 028/571-232, E-mail: sekretaria\_kkvush@yahoo.com*

Bazuar në nenin 12.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 2 pika 10 të Udhëzimit Administrativ nr.17/2008 për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve më të Rrezikshme për Fëmijët në Republikën e Kosovës, pikën 4 të Memorandunit të Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Vushtrrisë dt.12.03.2010, si dhe nenin 31 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2010, miratoi këtë:

**V E N D I M**

**Për themelim të Komitetit për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve më të Rrezikshme për Fëmijët në Komunën e Vushtrrisë**

**Neni 1.**

Me këtë vendim themelohet Komiteti për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve më të Rrezikshme për Fëmijë në Komunën e Vushtrrisë.

**Neni 2.**

Anëtaër të këtij komiteti caktohen:

- ❖ Rabije Haxhaj, kryesues, udhëheqëse e sektorit (qendrave të mjekësisë familjare),
- ❖ Lirije Ferizi, anëtar, udhëheqëse e sektorit të arsimit fillor dhe të mesëm.
- ❖ Tefik Maloku, anëtar, Sektori për Bujsësi.
- ❖ Ramadan Kutllovci, anëtar, Drejtoria Komunale e Kulturës Rinis dhe Sportit.
- ❖ Naser Saraçi, anëtar, Inspektori i punës që vepron në komunë.
- ❖ Ramiz Bunjaku, anëtar, QPS
- ❖ Kimete Mehana, anëtare, QPS.
- ❖ Bedrije Hyseni, anëtare, Policia e Kosovës, Njësia e Bashkësisë.
- ❖ Bukuriye Ferati, anëtare, Policia e Kosovës, Njësia kundër dhunës në familje.
- ❖ Feride Pllana, anëtare, Zyra e Punësimit.
- ❖ Bajram Beqiri, anëtar, Këshilli Komunal prind arsimtar.



### Neni 3.

Komiteti, detyrat dhe përgjegjësitë e tij do të i ushtroj konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr.17/2008 për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve më të Rrezikshme për Fëmijët në Republikën e Kosovës, si dhe Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar më 12.03.2010, në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Vushtrrisë.

### Neni 4.

Komiteti për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve më të Rrezikshme për Fëmijë, për punën e tij i paraqet raport në çdo gjashtë muaj Departamentit të Institutit për Politikë Sociale në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

### Neni 5.

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqnie Sociale në Vushtrri dhe Komiteti për Parandalimin dhe Eleminimin e Punëve më të Rrezikshme për Fëmijë në Komunën e Vushtrrisë.

### Neni 6.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Komunës  
**Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

---

Në bazë të nenit 13, pika 1 “a” të Ligjit mbi tokën bujqësore Nr.02/L-26, nenit 17 pika “b” dhe “f” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 31 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më 29.04.2010, mori këtë:

**V E N D I M**

**Mbi lejinin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në rrugë publike**

**Neni 1.**

Lejohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore, me kulturë kullosë e kl.5, të një pjese të parcelës kadastrale nr.165 në gjatësi prej 100m dhe gjerësi 4m me sipërfaqe të përgjithshme prej 400m<sup>2</sup>, e evidentuar në certifikatën e pronësisë nr.107 pronë e Komunës së Vushtrrisë, ZK Dumnicë e Llugës dhe e njëjta destinohet për rrugë publike.

**Neni 2.**

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër që ta zbatoj këtë vendim konform dispozitave ligjore në fuqi.

**Neni 3.**

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit  
Ferit Idrizi**